



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Nr. 604 prot.  
12

Tiranë, më 09 . 11 .20 22

**VENDIM**

Nr. 919 , Datë 09 . 11 .2022

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT  
MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E SHITJES  
SË UJIT MË SHUMICË PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME  
DURRËS SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09 . 11 .2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për miratimin e tarifave për shërbimin e shitjes së ujit me shumicë për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA.

**VËREN SE:**

1. ERRU nëpërmjet shkresës nr. 601 prot., datë 05.10.2022, informon Autoritetin e Konkurrencës se me Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 324 prot., datë 14.07.2022, të shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të shërbimit të shitjes së ujit me shumicë për ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizimit Durrës SHA. UK Durrës SHA ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë miratimin e tarifave të shërbimit të shitjes së ujit me shumicë për UK Vorë SHA dhe UK Kurbin SHA.
2. Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ERRU nëpërmjet strukturës së saj vendimmarrëse, Komisionit

Kombëtar Rregullator, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisive të qeverisjes vendore.

3. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU duhet të mbrojë konsumatorët nga çmimet monopol, të inkurajojë efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të paktë, të pasqyrojnë ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera midis kategorive të klientëve dhe llojeve të shërbimit dhe të aplikojë politika rregullatore të subvencionimit ndërmjet këtyre kategorive.
4. Bazuar në parashikimet e nenit 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ERRU përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të shitjes me shumicë dhe pakicë, të ujit për konsum publik, tarifat për ujërat e përdorura dhe trajtimit të tyre, ndërkohë që procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licensuari dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga ERRU.
5. Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA është rilicencuar me Vendimin e KKRR nr. 344 datë 23.09.2021, për të kryer a) shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik; b) largimin e ujërave të ndotur si edhe c) trajtimin e ujërave të ndotura për Bashkinë Durrës, Bashkinë Shijak, njësitë administrative Bubq, Thumanë (Bashkia Krujë), Fushë Kuqe (Bashkia Kurbin), Prezë (Bashkia Vorë).
6. Bazuar në VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA aplikon për miratimin e tarifave të shërbimit të shitjes së ujit me shumicë për UK Vorë SHA (Prezë) dhe UK Kurbin SHA ( Fushë Kuqe).
7. Informacioni mbi aplikimin, si edhe vendimi i KKRR nr. 324, datë 14.07.2022 “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të shërbimit të shitjes së ujit me shumicë” që i shërbehen UK Kurbin SHA (Fushë Kuqe) dhe UK Vorë SHA (Prezë) SHA nga ndërmarrja UK Durrës SHA, nuk është bërë transparent në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
8. Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA ofron shërbimin e shitjes me shumicë të ujit për UK Kurbin SHA (Fushë Kuqe) dhe UK Vorë SHA (Prezë) dhe tarifa aktuale është 0 lek/m<sup>3</sup>.
9. UK Durrës SHA propozon tarifën 32 lek/m<sup>3</sup> të tregtimit të ujit me shumicë për UK Kurbin SHA (Fushë Kuqe) dhe 35 lek/m<sup>3</sup> UK Vorë SHA (Prezë). Niveli tarifar i propozuar nga ERRU është më i ulët se ajo që ndërmarrja UK Durrës SHA propozon. Nevojën e

ndryshimit të tarifës së shitjes me shumicë të ujit nga UK Durrës SHA e argumenton bazuar në zbatim të Vendimit nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” në të cilën synohet që UK Durrës SHA të krijohet si shoqëri rajonale dhe do të ketë në zonën e shërbimit Bashkitë Durrës, Krujë, Kavajë, Rrogozhinë, Shijak, prandaj kërkon ti kalojë klientëve aktual, UK Vorë SHA dhe UK Kurbin SHA tarifën e shitjes së ujit me shumicë.

10. ERRU e gjykon të argumentuar nivelin tarifor për shërbimin e propozuar nga ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9902, datë 1704.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorit”, i ndryshuar si edhe kërkesave të Vendimit nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.
11. ERRU ka konstatuar se tarifa e shitjes së ujit me shumicë për herë të parë për UK Vorë SHA dhe UK Kurbin SHA nga ofruesi i shërbimit UK Durrës SHA është propozuar në nivele më të larta referuar analizës tekniko-ekonomike. ERRU ka miratuar tarifat për shitjen me shumicë të ujit të pishëm nga UK Durrës SHA për UK Vorë SHA me tarifën 29 lek/m<sup>3</sup> dhe për UK Kurbin SHA tarifën 28 lek/m<sup>3</sup>. Kjo tarifë do të shërbej për mbulimin e kostove totale, duke mos shkaktuar pasoja negative në mjedis nga veprimtaria e UK Durrës SHA në zonën e ofrimit të shërbimit ku do të aplikohet tarifa.
12. ERRU, për tarifat ka marr në konsideratë metodologjinë e miratuar me Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjetllës Kanalizime” si edhe kostot operative të shërbimit të shitjes së ujit me shumicë, për të cilat ka përcaktuar detyrën e ndarjes në sistemin kontabël të shërbimeve që UK Durrës SHA ofron, hartimin e planit të menaxhimit të aseteve, kostot e amortizimit të tyre të ndara për secilin shërbim.
13. Për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA, duhet të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të mundësoj ndarjen e këtyre shërbimeve sipas kostove të tyre operacionale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**


- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit, që tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA, për shitjen e ujit me shumicë për UK Vorë SHA dhe UK Kurbin SHA të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve,


të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit dhe të jenë transparente në faqen e ERRU-së.


II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Leida MATJA**  
  
Zv/Kryetar

**Rezana KONOMI**  
  
Anëtar

**Adriana BERBERI**  
  
Anëtar

**Durim KRAJA**  
  
Anëtar

  
**Denar BIBA**  
  
Kryetar